



SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
KOSOVË

FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë per aktivitetet e ndryshme si dhe aktivitetet ne kuadër të projekteve:

- "Aksion i përbashkët për decentralizim", projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian dhe që zbatohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosove, OFAP dhe KMOP e që për qëllim ka të kontribuoj drejt procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë.

si dhe

-"Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve "i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ne partneritet me HANDIKOS-Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve me Paralizë në Kosovë I cili ka për qëllim forcimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shërbimet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Janë të interesuar për një sallë të mjaftueshme, për realizimin e seminareve, konferencave si dhe për aktivitete tjera. Kjo sallë do të përdoret për të implementuar aktivitetet e planifikuara gjatë vitit që do të ofrojnë mundësi për zhvillim profesional të punonjësve, shkëmbimin e përvojave me partnerë dhe bashkëpunëtorë, zgjerimin e partneriteteve, promovimin e punës së organizatës etj.

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë sipas specifikacionit në vijim:

- Sallë për konferenca, prezente, aktivitete të ndryshme e cila ka kapacitet për 40-150 persona
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë konferencës
- Ofrimi I kafes (2 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkangjisni menynë të cilën e ofroni)
- Salla duhet të jetë në dispozicion 1 deri 4 herë në vit
- Salla duhet të ketë ndricim të mirë dhe të ketë qetësi

Salla duhet të ketë pajisjet si:

- Projektor,
- Tabelë për mbajtjen e letrave (flipchart)
- Mundësi për printim (e preferuar)

Salla duhet të jetë në Prishtinë ose në periferi, jo më larg se 10 km

Dokumentet e nevojshme:

1. Qertifikata e nr. Fiskal/ NUI
2. Qmimet e kuotuar në euro pa tvsh
3. Oferta financiare e ndarë me cmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë
4. Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare

Kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të mirë do të jenë si në vijim:

1. Përbushja e specifikacionit sipas Ftesës për Ofertë
2. Pas plotësimit të kriterëve -Çmimi më i lirë

Vlefshmëria e Ofertës duhet të jetë 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë.

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës dhe pronari i biznesit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe vërtetimin tatimor.

Për lehtësim të dorëzimit të ofertave, për shkak të situatës aktuale me pandemi, ofertat mund ti dërgoni në email adresën: procurement1@soskosova.org deri me datën: 28.08.2020